



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr576/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimiq dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), paraqitur kundër personave të paautorizuar në qendrat e votimit me nr 2710b/05d në fshatin Stanoc komuna e Vushtrisë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

### VENDIM

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e organizatës Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)

### ARSYETIMI

Më datën 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN-i në të cilën theksohet se me datën 12 dhjetor 2010 në vendvotimin nr 2710b/05d në fshatin Stanoc komuna e Vushtrise në shkollën fillore Migjeni gjatë tërë ditës në korridore por edhe në qendrën e votimit dhe në vendvotime ka pasur persona të paautorizuar, të cilët kanë penguar komisionerët për të kryer punën e tyre. Kjo gjë është vërejtur pasi që kryesuesi i këshillit të vendvotimit Osman Caka, është dashur të reagoj dhe të ndërhyjë disa here me qëllim që ti largoj nga kjo qender personat të cilët vinin kohe pas kohe në sallën e votimit. Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë materiale që do të shërbente si dëshmi për rastin në fjale.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, ne rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ndonjë provë e cila do të shërbente si dëshmi bindëse rreth rastit në fjalë, gjithashtu nuk ka cekur se cilët persona kane qene ata te cilët kane penguar procesin zgjedhor. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 576/2010 më datën 16.12.2010

**Kryesuesi i Panelit**

**Ferit Osmani**

